



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.337/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik PSHDK, Lorenc Culaj, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 27.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET PJESËRISHT E BAZUAR ankesa ZL.Anr.337/2025, e datës 24.10.2025, e parashtruar nga kandidati për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik PSHDK, Lorenc Culaj, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, ashtu që **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që fletëvotimet në vendvotimin-kutia e votimit 0806/02 – SHFMU “Nënë Tereza”, në Budisalc – Klinë, të rinumërohen dhe të përfshihen në rezultatin zgjedhor.

II. REFUZOHET E PABAZUAR pika e dytë e dispozitivit të ankesës ZL.Anr.337/2025, e datës 24.10.2025 lidhur me parregullësit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), në vendvotimet 0809, 0804, 0805, 0820, në komunën e Klinës, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale në Komunën e Klinës, nga radhët e subjektit politik PSHDK, Lorenc Culaj, me të cilën pretendon se Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK) ka konstatuar disa parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në QNR, si dhe devijime të dukshme të rezultateve në disa qendra të votimit. Përkatesisht, në qendrën e votimit 0806/02 – SHFMU “Nënë Tereza”, në Budisaic – Klinë, është vërejtur se sipas formularit zyrtar të rezultateve të plotësuar në vendvotim dhe të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit zgjedhor, PSHDK ka marrë 6 (gjashtë) vota. Në rezultate e përpunuara nga QNR, këto vota janë zhdukur plotësisht, duke mos figuruar as për subjektin, as për kandidaten znj. Brenda Gojani. Pas dorëzimit të materialeve në QNR, rezultati është ndryshuar në mënyrë të pajustificueshme duke ngritur dyshime për manipulim apo keqpërdorim të votave të PSHDK-së. Tutje, në qendrën e votimit - SHFMU "Motrat Qiriazit", Zajm, sipas të dhënave të marra nga komisioni dhe vëzhguesit tanë, PSHDK ka pasur 9 vota të mundshme, të dokumentuara

në procesverbalin e vendvotimit. Megjithatë, në rezultatet e publikuara nga QNR, PSHDK figuron me vetëm 8 vota, duke rezultuar në heqjen e një vote pa ndonjë arsye apo justifikim. Ky devijim, megjithëse numerikisht i vogël, përbën ndryshim të paautorizuar të rezultatit të konstatuar në vendvotim. Në qendrën e votimit SHFMU "Atë Shtjefën Gjeçovi", Zllakuqan disa votues të identifikuar si përkrahës të PSHDK-së kanë raportuar se kanë votuar për subjektin tone politik, por vota e tyre nuk figuron askund në rezultatet përfundimtare. Kjo situatë përben dyshim të bazuar për mos regjistrim ose keqpërdorim të votave, çka kërkon hetim dhe verifikim nga QNR dhe PZAP. Po ashtu, në këtë shkollë, ku PSHDK ka pasur prani të vëzhguesve dhe mbështetësve të dokumentuar, dyshohet për keqpërdorim dhe devijim të vullnetit qytetar. Nga të dhënat dhe raportimet nga përfaqësuesit tanë, PSHDK ka pasur 32 vota të mundshme, ndërsa në rezultatet përfundimtare figurojmë vetëm me 18 vota. Ky ndryshim i theksuar ngre dyshime serioze për mospërputhje të qëllimshme gjatë procesit të numërimit apo regjistrimit të rezultateve në QNR. Në qendrën e votimit - SHFMU "Atë Gjergj Fishta"- Jagodë, edhe pse PSHDK ka planifikuar komisioner ai nuk ka qenë i pranishëm pa ndonjë arsye nga vetë ai dhe KQZ-Kline. Kjo është një nder arsyejet e dyshimeve tona sepse është një ndër qendrat që pritshmëritë i kemi pasur shumë të mira. Nga raportimet e Qendrave të Votimit dhe Rezultateve Preliminare kemi marrë 7 vota nga 17 e më shumë të mundshme. Provat e bashkangjitura: Kopjet e formularëve të rezultateve nga vendvotimet përkatëse, ku PSHDK figuron me më shumë vota sesa në raportet e QNR; Lista e nënshkrimeve të votuesve për qendrat e përmendura, ku verifikohet pjesëmarrja e mbështetësve të PSHDK-së; Kopje e bexhit të anëtarit të komisionit z. Albert Gojani; Raportet nga QNR që dëshmojnë ndryshimet e rezultateve; Deklarata të votuesve dhe vëzhguesve për rastet e Zllakuqanit dhe Ujmirrit. Në bazë të provave dhe pretendimeve të paraqitura, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (PSHDK) kërkon që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) të: urdhëroje verifikimin dhe rinumërimin e votave për qendrat e votimit të përmendura; hetojë mospërputhjet dhe ndryshimet e paautorizuara të rezultateve ndërmjet vendvotimeve dhe QNR-së dhe të konstatojë përgjegjësinë e personave të përfshirë në manipulim të mundshëm apo në konflikt interesi.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 25.10.2025, ka deklaruar se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë:

Në lidhje me pretendimet e palës ankuese për QV 0806/02 "SH.F.M.U" Nëna Terezë në Budisaic, Klinë, KQZ pas pranimit të kërkesës nga PZAP, me datën 25.10.2025, ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Klinës, nga i cili ka marrë përgjigjen si më poshtë:

“Komente për ankesën nr.337”

Më lejoni t'ju njoftoj me aktivitetet e punës në QKN (Qendra Komunale e Numërimit Palestra Adem Jashari, Klinë), Me aktivitetet e punës në QKN kemi filluar më datën 13.10.2025, më ndërrimin e dytë prej orës 16:00 (dhe kemi vazhduar për tre ditë resht deri më 15.10.2025 në ndërrimin e parë të së mërkurës ora 16:00, ka përfunduar i gjithë aktiviteti i numërimit. Procedurat kanë vijuar sipas ligjit për zgjedhjet dhe rregullorja për QKN-n palët janë kanë prezentë dhe kanë mundur të ushtrojnë të drejtën e tyre. Për pretendimet ose vërejtjen lidhur më numërimin në QKN.

Komentet lidhur më an. Nr. 337, për vendvotimin 0806/02, evidentohet se në vendvotim në ditën e zgjedhjeve figurojnë 006 vota. Për subjektin PSHDK, ndërsa në formularin digjital të krijuar në QKN, mungojnë, për më tepër janë bartur të subjekti një rubrikë më lartë AAK. Ne

si KKZ më shqyrtimin e këtyre të dhënave vërejtëm këtë lëshim në bartjen e votave, për të vërtetuar plotësisht pretendimet bazuar në të dhënat e dy formularëve nga vendvotimi dhe QKN, sugjerojmë hapjen e kutisë së vendvotimit 0806/02.

Komentet tona si për pretendimet në qendrat 0809, 0804, 0805, 0820, janë pretendime të pa bazuara ose specifikuar qartë, së për cilat vendvotime bëhet fjalë, por vetëm aludime ku sipas palës pretenduese kanë pasur indice së kanë votues potencial pa ndonjë provë konkrete. Të cilën do të mund të trajtonim më analizë më të thellë, kur dihet fakti së këto QV janë gjithsej 11 vendvotime.”

Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). KQZ, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese për QV SH.F.M.U Motrat Qiriazhi - Zajm, At Shtjefën Gjeqovi - Zllakuqan, Ali Krasniqi Ujmirë, At Gjergj Fishta Jagodë, që mbështeten në deklaratimet e vëzhguesve, mbështetësve, ose personave të tjerë, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor gjendet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë në pikën e parë të dispozitivit të ankesës nga subjekti politik PSHDK me të cilat pretendon se në qendrën e votimit 0806/02 – SHFMU “Nënë Tereza”, në Budisaic – Klinë, është vërejtur se sipas formularit zyrtar të rezultateve të plotësuar në vendvotim dhe të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit zgjedhor, PSHDK ka marrë 6 (gjashtë) vota, ndërsa në rezultate të përpunuara nga QNR, këto vota janë zhdukur plotësisht, duke mos figuruar as për subjektin, as për kandidatin znj. Brenda Gojani, Paneli i vlerësoi se janë të qëndrueshme, pasi që nga hetimi i kryer nga ana e Panelit janë vërtetuar këto pretendime, se ka mospërputhje mes votave tek formulari zyrtar i rezultateve në vendvotim në ditën e zgjedhjeve dhe formularit të krijuar në QKN.

Paneli gjatë administrimit të provave ka konstatuar këtë gjendje faktike: në vendvotimin 0806/02 në ditën e zgjedhjeve figurojnë 6 vota për subjektin politik PSHDK, ndërsa tëk formulari digjital i krijuar në QKN të njëjtat mungojnë. Nga përgjigje e KQZ konstatohet se për vendvotimin 0806/02 është evidentuar se në vendvotim në ditën e zgjedhjeve figurojnë 006 vota për subjektin PSHDK, ndërsa në formularin digjital të krijuar në QKN, mungojnë, për më tepër janë bartur të subjekti një rubrikë më lartë AAK.

Andaj nga kjo gjendje faktike, Paneli ka vlerësuar se nga ana e Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), në vendvotimin 0806/02 në komunën e Klinës, është bërë bartja e votave nga njëri subjekt tek tjetri, përkatësisht është bërë bartja e 6 votave nga subjekti politik PSHDK tek subjekti politik AAK.

Në bazë të lartcekurave paneli vlerëson se në vendvotimin 0806/02, janë ndërmarr veprime të cilat janë në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 105 i LZP-së Nr. 08/L-228, i cili decidivisht thotë *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzetë e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*, si dhe Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave Nr.01/2025, neni 13, paragrafi 12, lidhur me nënpagrafin 12.1 *“Në rast se PZAP konstaton se ka ndodhur shkelje e LZP-së dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP që në raste të jashtëzakonshme: 12.1 të urdhëroje KQZ-në që të rinumëroj fletëvotimet në një vendvotim apo qendër votimi.”*

Bazuar në të lartcekurat, Paneli duke u mbështetur në nenin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave Nr.01/2025, konstaton se në vendvotimin 0806/02 në komunën e Klinës, është bërë bartja e votave nga njëri subjekt tek tjetri, përkatësisht është bërë bartja e 6 votave të cilat i kane takuar subjektit politik PSHDK tek një subjekt tjetër politik.

Andaj konform nenit 118 paragraf 1 të LZP, PZAP ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi

Ndërsa sa u përket pretendimeve ankimore të cekura si në pikën II të ankesës lidhur me vendvotimet 0809, 0804, 0805, 0820, të cilat nuk janë të specifikuar qartë, por vetëm janë përgjithësuar dyshime për mungese të votave janë vetëm pretendime deklarative të subjekti politik se kanë votues potencial dhe të njëjtat i ka mbështetur vetëm në deklaratimet e vëzhguesve, mbështetësve apo personave të tjerë, pa ndonjë provë konkrete. Paneli sqaron se bazuar në nenin 4 paragraf 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjersa shpërfajta e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë të votës.

Prandaj, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë gjegjësisht në pikën II të ankesës, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë se ka pasur veprime që kanë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së. Përkatësisht, Paneli, vlerësoi se ankesa gjegjësisht pjesa e dytë është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, lidhur me pikën II të ankesës nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen

përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 105, nënin 117 paragrafi 3, nënit 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nënin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave Nr.01/2025, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.337/2025, datë 27.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nënit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.